



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
01Nr 104/02-28334/22
Kaçanik, 26.10.2022

Në bazë të nenit 40.2 (b) të Ligjit Nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008) të Ligjit Nr.03/L-048 –Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/03 Qershor 2008) të Ligjit Rr.03/L-221-Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048-Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit Nr.08/L-066 -Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/31 Dhjetor 2021), të nenit 61 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 26 Tetor 2022, mori këtë:

V E N D I M PËR TRANSFERIN DHE RIALOKIMIN E MJETEVE BUXHETORE

1. Transferet e mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale (fondi 10):

Nga nën-programi:

Buxheti-17528 Kodi funksional 0112, nga projekti me kod 43973 “Mjetet për shpronësime” shuma prej 19,350.00€

Transferohen në kategorinë e investimeve kapitale (fondi 10):

Në nën programet:

- Planifikimi urban dhe inspeksioni-66445 Kodi funksional 0620 në projektin me kod 50201 “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve ne pjesen urbane dhe rurale” shuma prej 19,350.00€.

2. Rialokimet e mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale (fondi 10):

Nga nën-programi:

- Planifikimi urban dhe inspeksioni-66445 Kodi funksional 0620, nga projekti me kod 51213 “Ndertimi dhe rregullimi i Qarshisë së vjetër të Qytetit”, shuma prej 45,000.00€.

Rialokohen në kategorinë e investimeve kapitale (fondi 10):

Në nën programin:

Planifikimi urban dhe inspeksioni-66445 Kodi funksional 0620, në projektin me kod 50201 “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve ne pjesen urbane dhe rurale” shuma prej 45,000.00€.

3. Për realizimin e këtij Propozim Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante); dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli